

**VENDIM**  
**Nr.1205, datë 11.12.2009**

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË PËRFUNDIMIT TË PROCEDURAVE TË  
PROKURIMIT, PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË DOGANAVE DHE PËR  
DEGËN E DOGANËS, FIER, SI AUTORITETE KONTRAKTORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe të degës së doganës, Fier të përfundojnë, brenda datës 15 dhjetor 2009, procedurat e prokurimit, me objekte “Ofrimi i shërbimeve me rojë private” dhe “Shtesë kati dhe rikonstrukcion i zyrave të degës së doganës, Fier”, me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit për vitin 2009. Brenda këtij afati të përfshihet edhe lidhja e kontratave përkatëse.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**